



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2025

Datë. 26.06.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Rregulloren Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2025, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për mbështetje Financiare për KB “Vëllaznimi” Meshkujt, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës për mbështetje Financiare në vlerë prej 24,000 € për Klubin e Basketbollit KB “Vëllaznimi” Meshkujt nga Gjakova.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi të rekomanduara nga komisioni vlerësues sipas thirrjes publike për Projektet /programe të OJQ-ve në fushën e Sportit në Komunën e Gjakovës, do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të këtij Klubi.
3. Shuma e mjeteve financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi do të ndahen nga Kategoria e Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e Komunës së Gjakovës nga Kodi Buxhetor 21/632/85016/200/00000/0820 në vlerë prej 24,000€.
4. Obligohen Organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve Financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Klubit të Basketbollit KB “Vëllaznimi” Meshkujt.
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Arbënisha Kuqi
 Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	23.06.2025 40605-32201
Për:	Arbëneshë Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për mbështetje financiare për KB "Vëllaznimi"- Meshkujt

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Gjakovës, dispozitave të Rregullores me Nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-v, Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, si dhe Rekomandimit të Komisionit Vlerësues, me datën 23.06.2025 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për mbështetje financiare të KB "Vëllaznimi" – Meshkujt në Gjakovë, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të aktiviteteve të këtij klubi, të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues, sipas thirrjes publike për projekte/programe të OJQ- ve, në fushën e Sportit.
2. Mjetet për mbështetje financiare për KB "Vëllaznimi" - Meshkujt të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport nga kodet buxhetor 21/632/85016/200/00000/0820 në vlerë prej 24,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	23.06.2025
Për:	z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Komisioni Vlerësues
Përmes:	Adea Roka Pylla – drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
Tema:	Rekomandim

I nderuari z. Kryetar,

Në procesin e Tëtrijës Publike për mbështetje financiare të projekteve / programeve për OJQ-të në fushën e sportit të hapur nga DRKS, janë pranuar edhe kërkesat e KFC “Vëllaznimi” dhe KB “Vëllaznimi” - Meshkujt.

Meqë, KFC “Vëllaznimi” dhe KB “Vëllaznimi” – Meshkujt veprimtarinë sportive e bazojnë në Planin Vjetor të Punës, për realizimin e së cilës kërkohet vlerë e lartë e mjeteve financiare për subvencionim, gjithashtu duke u bazuar në historikun e gjatë të klubeve dhe impaktin e tyre tek komunitetin në përgjithësi, si dhe nevojave të vazhdueshme për realizimin e qëllimeve të klubeve për të gjitha grup moshat, talenteve të rinj dhe futbollit e basketbollit në përgjithësi si dhe për zhvillimin dhe avancimin e sportit, Komisioni ka propozuar që për realizimin e këtyre projekteve, të rekomandoj shumë në vlerë si: KFC “Vëllaznimi” shumë prej 40.000 euro dhe KB “Vëllaznimi” – Meshkujt shumë prej 24.000 euro.

Andaj, rekomandojmë kryetarin e Komunës që të aprovoj shumat e lartëcekura dhe të njëjtat ti procedoj për miratim në Kuvendin Komunal.

Gjeni të bashkangjitur:

Projekt - Aplikacionin për mbështetje financiare të parashtruar nga KFC “Vëllaznimi” dhe KB “Vëllaznimi” – Meshkujt.

Fisnik Caka (Kryesues)

Labiriot Pëfendiu (Anëtar)

Erblina Dinarama (Anëtare)

Myftar Shala (Anëtar)

Bekim Syla (Anëtar)

Me respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Rruga Terezi – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel. 030 390 322 391
kk.rrks.gov.net/gjakove/